



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 4367 / Prot  
11

Tiranë, më 05.06 2026

**UDHËZIM**

Nr. 11 datë 05.06.2026

**PËR  
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË  
KËRKIMORE-SHKENCORE TË PUNONJËSIT KËRKIMOR-SHKENCOR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 29 të ligjit nr. 109/2024 “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”,

**U D H Ë Z O J:**

1. Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për vlerësimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të punonjësve kërkimorë-shkencorë në institutet apo njësitë e veçanta kërkimore-shkencore në Republikën e Shqipërisë.
2. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit monitoron rezultatet e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të punonjësve kërkimorë-shkencorë.
3. Procesi i vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore realizohet në mënyrë periodike, sipas afateve të vendosura nga vet institutet apo njësitë e veçanta kërkimore-shkencore, në përputhje me kriteret orientuese të mëposhtme, të vlerësuara gjatë periudhës së vlerësimit:
  - a) Të ketë publikuar 1-3 botime ose artikuj shkencorë në revista ndërkombëtare të indeksuara ose në revista kombëtare të kategorive A ose B;  
(0-15 pikë)
  - b) Të ketë monografi të botuara në vendet e BE-së ose OECD-së dhe G-20-ës, të cilat përmbushin kushtet e origjinalitetit, janë të pajisura me kod ISBN dhe janë vlerësuar në përmbajtje si punime shkencore nga të paktën 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore;  
(0-10 pikë)
  - c) Të ketë monografi të botuara brenda vendit, të pajisura me kod ISBN dhe të vlerësuara në përmbajtje si punime shkencore nga të paktën 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore;

- (0-8 pikë)
- d) Të ketë realizuar veprimtari të kërkimit shkencor në një nga fushat prioritare të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për shkencën;  
(0-5 pikë)
- e) Të ketë marrë pjesë në 1-2 projekte të financuara nga programet kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit, si drejtues, koordinator ose anëtar;  
(0-10 pikë)
- f) Të ketë patentë për shpikje të regjistruar pranë strukturës përgjegjëse për pronësinë industriale konform kuadrit ligjor në fuqi për patentat për shpikje (nëse ka);  
(0-8 pikë)
- g) Të ketë marrë pjesë në projekte kërkimore-shkencore të fituara nga programet kuadër të BE-së për kërkim shkencor, si koordinator ose partner në projekt;  
(0-12 pikë)
- h) Të ketë marrë pjesë si referues në 1-3 konferenca shkencore, nga të cilat 1 (një) të jetë konferencë shkencore ndërkombëtare në një nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së dhe G-20-ës, të botuar në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN;  
(0-8 pikë)
- i) Të ketë çmime ndërkombëtare të fituara për punën kërkimore-shkencore në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës, nga institucione të autorizuara për lëshimin e tyre (nëse ka);  
(0-5 pikë)
- j) Të ketë çmime kombëtare të fituara për punën kërkimore-shkencore, nga institucione të autorizuara për lëshimin e tyre.  
(0-5 pikë)
- k) Të jetë i angazhuar si personel akademik me kohë të pjesshme në një nga institucionet e arsimit të lartë;  
(0-3 pikë)
- l) Të jetë i angazhuar në grupe pune institucionale apo ndër-institucionale në procese të politikëbërjes për hartimin e akteve ligjore, nënligjore, dokumenteve politike, strategjive, raporteve të monitorimit (kombëtare apo ndërkombëtare), si ekspert i fushës kërkimore-shkencore përkatëse;  
(0-3 pikë)
- m) Të ketë marrë pjesë të paktën në 1 (një) projekt kërkimor-shkencor të zbatuar në kuadër të një marrëveshjeje bashkëpunimi me industrinë, për zhvillimin e një produkti ose procesi inovativ me impakt në shoqëri.  
(0-8 pikë).
4. Vlerësimi bëhet për kriteret orientuese që plotëson punonjësi kërkimor-shkencor, pa tejkaluar kufirin maksimal të pikëve të përcaktuar në pikën 3 të këtij udhëzimi, nga instituti apo njësia e veçantë kërkimore-shkencore ku ushtron aktivitetin punonjësi kërkimor-shkencor, nëpërmjet strukturave të ngritura për këtë qëllim. Përpunimi dhe administrimi i të dhënave realizohet nëpërmjet platformës elektronike Sistemi Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor - ACRIS.

5. Punonjësit kërkimorë-shkencorë përditësojnë të dhënat lidhur me veprimtarinë e tyre kërkimore-shkencore, në mënyrë periodike, sipas afateve të vendosura nga vet institutet apo njësitë e veçanta kërkimore-shkencore, në platformën elektronike Sistemi Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor – ACRIS. Instituti apo njësia e veçantë kërkimore-shkencore, ku punonjësi kërkimor-shkencor ushtron aktivitetin, verifikon dhe miraton të dhënat e raportuara.
6. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të punonjësve kërkimorë-shkencorë në platformën elektronike Sistemi Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS) dhe faqen zyrtare të saj, duke garantuar transparencë, akses publik dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, punonjësit kërkimorë-shkencorë, institutet dhe njësitë e veçanta kërkimore-shkencore në Republikën e Shqipërisë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**MINISTRI**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**

